

540
05.04.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST

Tiranë, më 04.04.2018

Drejtuar: Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës

Prof. Dr. Agron CUKA

Lënda: Raporti i Punës për Muajin Mars i NJSBC-së pranë UST.

RAPORT

Në zbatim të vendimeve nr. 13 datë 27.02.2018 të Senatit të UST dhe atij nr. 9 më datë 02.03.2018 të Bordit të Administrimit të UST, filloi punën më 03.03.2018 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga:

Prof. Dhimitraq Stratobërdha Kryetar
Dr. Mirjeta Cenaj Anëtar
Doc. Anduela Lile Anëtar

Gjatë muajit Mars 2018 te tre anëtarët qysh në takimin e parë u njohën dhe përcaktuan detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL.

U hartua një Plan Veprimi për vitin 2018. U përcaktuan informacionet që duhen marrë nga njësitet kryesore, administrata etj, për të krijuar dokumentacionin e kësaj njësie në përputhje me ligjin e aktet e tjera nënligjore.

Gjatë këtij muaji është punuar për njohjen në detaje të përgjegjësive të njësisë dhe gjetjen e referencave për tu njohur konkretisht me Manualin e ASCAL e me eksperiencat e institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Qëllimi ka qenë përgatitja e njësisë për të hyrë në fazën e dytë të vlersimeve, që është edhe më e rëndësishmja e që duhet tu përgjigjet standardeve ku do të arrijë çdo IAL.

Ky raport është përgatitur sipas pikes 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03.2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari i NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha